



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1679 Prot.

Tiranë, më 10.09.2026

VENDIM

Nr. 59 Datë 10.09 2026

**“PËR
MIRATIMIN E TARIFËS SË VETME TË REGJISTRIMIT PËR KONKURS, NË DY
PROGRAMET BACHELOR NË FVFR, NË UNIVERSITETIN E SPORTEVE TË TIRANËS
PËR VITIN AKADEMIK 2026-2027”**

Në zbatim të Ligjit nr.80/2015"Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në RSH të nenit 3, pika 3, gërma ç), nenit 6 pika 28, nenit 49, nenit 83, të nenit 109, pika 1, të Statutit të UST, të Rregullores së UST, në kërkesën e Dekanit të FVFR shkresë me nr. 1627 prot., datë 02.09.2026 "Kërkesë për përjashtim nga pagesa e dyfishtë e tarifës për kandidatët që konkurojnë njëkohësisht në dy programe "Bachelor" të ofruara nga FVFR", në Vendimin e Rektorati nr. 107 datë 04.09.2026, në Vendimin e Senatit Akademik nr. 117, datë 08.09.2026, Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 10.09.2026,

V E N D O S I :

1. Të miratojë që studentët të cilët konkurojnë në dy programet Bachelor në FVFR, në Universitetin e Sporteve të Tiranës, t'i nënshtrohen një tarife të vetme prej 5,000 (pesëmijë lek), lidhur me regjistrimin në konkursin praktik të aplikantëve
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Administratori, FVFR, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të Universitetit të Sporteve të Tiranës.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen www.ust.edu.al.

KRYETAR I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

Artur ÇOBANI

